



RAPORT VLERESIM TE NDIKIMIT NE MJEDIS

PROJEKTI I PROPOZUAR: SPITALI MEMALIAJ”
VENDODHJA E ZONES SE ZHVILLIMIT: BASHKIA: MEMALIAJ RRETHI: TEPELENE
QARKU: GJIROKASTER
INVESTITOR I PROJEKTIT TE PROPOZUAR: DREJ.E SHENDETIT SPITALOR



07, 2017
ENVIRONMENTAL ENGINEERING
TIRANË



Informacion mbi Projektin:

Titulli i projektit: Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (Procedura paraprake)


Emri i raportit: SPITALI MEMALIAJ

Investitori DREJ.E SHENDETIT SPITALOR

Bashkeautor: Ekspert Mjedisi. Fatjona Levani PF

Data e këtij raporti: Qershor, 2017

Aprovuar:



Ekspert i Licensuar. Fatjona Levani

Ekspert Mjedisi. Fatjona Levani PF

NIPT: L52227035P LN(3492-07-2017)



Pasqyra Permbledhese..... Faqe

1.	Hyrje.....	2
2.	Kuadri ligjor, rregullator per VNM-ne.....	3
2.1.	Qellimi i Vleresim Ndikimit ne Mjedis (VNM).....	3
2.2.	Legjislacioni perkates per VNM-ne.....	4
2.3.	Politikat dhe Strategjite.....	5
3.	Pershkrimi i projekt zhvillimit.....	5
3.1.	Qellimi i projektit.....	5
3.2.	Propozimet e projektit.....	6
3.3.	Pershkrimi i struktures funksionale dhe fizike.....	6
3.3.1.	Struktura e impianteve te ndertesese.....	7
3.4.	Projekte te tjere plotesues.....	9
3.4.1.1.	Rrjeti i kanalizimeve te ujerave te bardha.....	9
3.4.1.2.	Rrjeti i Kanalizimeve te Ujrave te Zeza.....	9
3.4.2.	Rrjeti telefonik ne zone ne studim.....	10
3.4.3.	Gjelberimi i zones ne studim.....	10
3.4.4.	Rrjeti i furnizimit me ujë.....	10
4.1.1.	Rrjeti hidrografik te zones ne vleresim.....	11
4.1.2.	Zonat e ndjeshme mjedisore.....	12
4.2.	Cilesia e ajerit.....	12
Transporti	12	
Ndërtimi	12	
Energjia	12	
4.2.1.	Profilat e ndotjes së ajrit.....	12
4.2.2.	Te dhena ekonomiko-sociale.....	13
5.1	Metodologjia e vleresimit.....	15
5.2	Normat e cilirimeve ne ajer / uje dhe respektimi i nivelit te zhurmave konform legjislacionit te fuqi.....	15
4.	Plani i menaxhimit dhe monitorimit.....	18
5.	Rekomandime.....	22

1. Hyrje

Ky raport i VNM-se po pergatitet me kerkese te subjektit "Drej.e Shendetit Spitalor" i cili kerkon te realizoj projektin "Njesi sherbimi Shendetsore Spitali Rajonal Memealiaj", Bashkia Memaliaj. Ne kete raport te VNM ceshtet kryesore qe do te merren ne konsiderata jane:

1. Te gjitha ndikimet e mundshme mjedisore dhe potenciale jane marre ne konsiderate si dhe jane vleresuar vetem gjate fazes se ndertimit, aty ku gjykohen te parashikueshme;
2. Zhvillimi i propozuar eshte i sigurt dhe i qendrueshem nga pikepamja mjedisore dhe sociale persa i perket ndikimeve te mundshme mjedisore dhe sociale;
3. Konsultimet me palet e interesura mbi projektin dhe ndikimet e tij.

Ky raport i VNM-se ka per qellim percaktimin e rregullave per kontrollin e grumbullimit, transportimit, magazinimit dhe menaxhimine mbetjeve te ndertimit dhe inerteve qe do te prodhohen gjate procesit te ndertimit te tij per te siguruar mbrojtjen e shendetit publik dhe te mjedisit perreth pa cenuar ne asnje rast ciklin e saj natyror. Pra ky projekt te kete nje zhillim te qendrueshem.

2. Kuadri ligjor, rregullator per VNM-ne

2.1. Qellimi i Vleresim Ndikimit ne Mjedis (VNM)

I percaktuar me fjale te thjeshta, VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetsores jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimit te propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegjel kyç per vendimarrjen nje nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

- Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.
- Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe

- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjene termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve; dhe
- Permiroson aspektet sociale te projektit

2.2. *Legjislacioni perkates per VNM-ne*

Per me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacion mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis

Kuadri për VNM-n sigurohet ne menyre te drejtperdrejt nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, ligjet e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) janë zhvilluar dhe kanë hyrë në fuqi gjatë dekadës së fundit. Vlerësimi Strategjik Mjedisor përmendet në Ligjin, "Për Mbrojtjen Mjedisore".

Ligji Nr.10440, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" ne nenin 4 per "Projektet qe i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis" thuhet:

- 1- Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis i nenshtrohen te gjitha projektet dhe veprimtaritet qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, perpara miratimit te tyre nga organet perkatese.
- 2- Projektet dhe veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresimin e ketij ndikimi:
 - procesit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis
 - procesit te permbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Si dhe mbeshtetur ne Vendimi nr.805,dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkojne Leje Mjedisore" ku projekti yne nuk eshte i klasifikuar ne kete liste te aneksit I.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

- VNM i permbledhur. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte

qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1.

- VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet MMPAU mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit, ne menyren e detajuar ne Shtojcen 3 te Ligjit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementura ne zonat e mbrojtura te Republikes se Shqiperise apo zona bregdetare te Shqiperise.

2.3. Politikat dhe Strategjite

- Strategjine Ndersektoriale te Mjedisit- Miratura VKM Nr.847, date 29.11.2007, si pjese e Strategjise Kombetare per Zhvillim e Integrim
- Plani Kombetar i Veprimit ne Mjedis- Miratuar me VKM Nr.34, date 28.01.2002
- Plani Kombetar per Zbatimin e Marreveshjet se Stabilizim Associmit
- Programi i Qeverise 2005 – 2009
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Zhvillimin e Turizmin Kulturor dhe Mjedisor
- Strategjia afatgjate e zhvillimit te sistemit shendetesor ne Shqiperi

3. Pershkrimi i projekt zhvillimit

Ky projekt ne vleresim " Njesi sherbimi Shendetsore Spitali Rajonal Memaliaj " parashikon realizmin e nje shtepie kurimi private qe mendohet te ndertohet ne zonen e Memaliajt. Ky projekt eshte projektuar konfom kushteve perkatese per te mundesuar funksionim sa me optimal te kesaj shtepie kurimi, duke shmangur ne cdo rast ndikimin ne nivele te ndjeshme dhe shqetesuese per komunitetin perreth zones.

3.1. Qellimi i projektit

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi i " Njesi sherbimi Shendetsore Spitali Rajonal Memaliaj " Objekti kryesor i tij eshte qe te realizohet nje strukture sanitare e afte te administroje operacione kirurgjikale te nje rendesi te madhe strukturimit te diagnostikuese te cilave iu

niveli te larte, duke i dhene nje reparteve te analizave dhe

- ZONA E TREGTISE DHE BIZNESIT
- RRUGE DHE SHESHE
- SIPERFAQE E GJELBERUAR DHE TERRENE SPORTIVE
- TERRITORE BANIMI ME BANESA KOLEKTIVE
- TERRITORE BANIMI ME BANESA VETIAKE
- SIPERFAQE UJORE
- TERRITORE SHOQERORE
- MASIVE TE GJELBERUAR PYJE

shtohen nje zone e rendesishme rehabilitimi. Pozicioni i saj, ne dukje i vecuar, e ben ate te pershtateshme per realizmin e nje strukture shendetsore, duke marre te mirat e afersise me aksin rrugor dhe qetesine e terrenit ku ndodhet.

Keshtu Ndertesa kthehet ne nje barriere nga rruga per zonen e vendosur per park te gjelbert, nje vend ne kontakt me natyren dhe vend e vendosur ne jug te akseve te qarkullimit,ne forme trapezoidi,e hapur kundrejt jugut,permes kodrave te ptejme, te con ne ndertimin e nje blloku te ngjeshur me nje orientim optimal veri- jug. Ndertesa behet nje barriere drejt rruges ne mbrojtje te hapesires se destinuar per park,rruge dalje natyrale dhe vend pushimi per pacientet dhe personelin e klinikes . Nga kjo premise rrjedh sistemimi territorial i klinikes dhe hyrjeve per ne te,duke bere dallimin e atij te sherbimit nga ai i hyrjes ne klinike.

3.2. *Propozimet e projektit*

Ky projekt propozon realizimin e nje shtepie kurimi private qe mendohet te ndertohet ne Memaliaj ne nje ndertese te re mbi terrenin e lire ne pronesine e shoqerise investuese e cila do te marre persiper pergjegjesine e administrimit te kompleksit.

3.3. *Pershkrimi i struktures funksionale dhe fizike*

Struktura fizike a ndertesese synon te jete e thjeshte dhe te beje dallimin ne maksimum te elementeve konstruktiv dhe organizues. keshtu perreth trupit te fabrikes kryesore , e organizuar mbi pese nivele siper dhe nje nen toke , shperndahen volumet dytesore dhe aksesore me funksione te ndryshme specifike dhe te qarta. Struktura e jashtme me dy kate,me forme katerkendeshi, me oborr gendror,ge mirepret zonat hyrese dhe marrese,restaurant-bar dhe zyrat drejtuese,eshte pozicionuar ne anen e jugut drejt zonave te gjelberuara.

Nje volum i plote,ne kendin veri-lindje,permban shkallen kryesore te lidhjes midis niveleve, kryesisht per vizitoret e jashtem. Dy element te tjere, ngjitur me trupin kryesor, ne fasaden veriore, realizojne hyrjen e sherbimit te personelit te brendshem,dhoma e ngrohte per hyrjen(pranimin) e te semureve dhe te invalideve dhe nenstacionet e sherbimeve te implanteve teknologjike.

E gjithë struktura e pare nga jashte eshte e perbere nga dy tema qe perbejne organizimin fizik, bazamenti, elementi lidhes, struktura superiore, elementi ne lartesi , karakterizohen nga qellimi per te gene e lehte. Bazamenti , lidhur me terrenin dhe hyrjet , permban te gjitha zonat e sherbimit, ambulatoret dhe labororet, me pak fjale te gjitha zonat e destinuar per analiza dhe diagnoza.

Zonat e kurimit, duke u nisur nga kati i dyte, kane ne fakt nje fasade plotesisht vetrate dhe te lehte drejt

ambientit rrethues, ne menyre qe ta bejne me mikpritese sallonin dhe te lejoje te fuse ne brendesi te godines cilesine e ambientit te jashtem, ne kete rast hapesiren e gjelbert qe do ta rrethoje.

Logjika organizative e struktures ne kompleksin e saj kerkon te mbuloje optimalisht objektivat vashduese:

- Optimizimi i levizjeve vertikale dhe horizontale nepermjet percaktimit zonave te specializuara, rruget e levizjes se mjekeve dhe te operatoreve te brendshem, rruget e vizitoreve te jashtem per dhe nga zonat e shtrimit dhe te ambulateve, levizjen e mallrave, korsite per te semuret e shtruar brenda struktures;
- Optimizimi i pozicionimit te makinerive te trajtimit te ajrit, qe duhet t'iu pergjigjen kerkesave te ligjeve shendetesore per menaxhimin e hapesirave ajrore te cilat kane ne zonen kirurgjikale zemren e sherbimeve ne duhet te kryejne.

3.3.1. *Struktura e impianteve te ndertesës*

Struktura e impianteve per to realizuar, ka dy objektiva themelore , nga nje ane minimizimin e kostove te impianteve si ndertuese dhe menaxhuese nga ana tjeter te mundesoje plotesisht autosificencen punuese ne rast mungese te nevojave primare te sherbimit.

Ndertimi i impianteve eshte e bazuar ne thjeshtesine maksimale ndertuese ,me realizimin e dy tubave te medhenj ku mund te kalojne ne menyre te vecuar impiantet derjt ambienteve te ndryshem, me vendosjen e sallave kirurgjikale ne katin e fundit, ne menyre qe sallat te jene ne kontakt direkt me impiantin e trajtimit te ajrit, te cilat jane ne tarracen e godines.

Struktura e fasades eshte studiuar ne menyre qe te lejoje nje kontroll perfekt te ndryshimeve termike te ambientit, me ane te nje fasade aktive, e cila lejon hyrjen dhe daljen e ajrit te ndermjetem te saj.

Kjo realizohet nga principi ku ajri i ndermjetem i fasades:

- Te vihet ne levizje gjate veres, duke zvogeluar hyrjen e nxehtesise.
- Te krijoje nje shtrese izoluese gjate periudhes dimerore duke zvogeluar daljen e nxehtesise

Tipologjite e implanteve qe do te ndertohen duhet te funksionojne ne baze te situates individuale te ndertesës dhe karakteristikave teknike te zones ku ndertohet , per te cilat eshte e nevojshme te parashikohet autosuficienca komplet e struktures.

Tipologjite e implanteve qe do te perdoren mund te sintetizohen sa me poshte :

– **Zona e magazinimit:**

- Lende djegese;

- Gazet mjekesore;

– **Impiante prodhuese:**

- Impiante te trajtimit te ajrit,UTA;
- Impiante per ngrohjen;
- Impiante per ftohjen;
- Impiante te energjise elektrike;
- Impiante per prodhimin e avujve te ujit;

– **-Impiante shperndarese:**

- Impianti per shperndarjen e ftohje/ngrohjes;
- Implant i shperndarjes se ajrit;
- Implant per shperndarjen e gazit mjekesor;
- Implant per shperndarjen e ujit;
- Implant per shperndarjen e energjise;
- Rrjeti informatik;

– **-Impiantet e trajtimit te mbetjeve(jo pjese e ketij projekti):**

- Impianti i trajtimit te mbeturinave speciale;
- Impianti i i trajtimit te mbetjeve te pergjithshme ;
- Implanti i trajtimit te lengjeve special;

– **-Impiantet e kontrollit:**

- Implant kunder zjarri
- Kontrolli i nderteses ;
- Impianti i sigurise;

3.4. Projekte te tjere plotesues

3.4.1.1. Rrjeti i kanalizimeve te ujerave te bardha.

- ⇒ Kanalizimet e Ujrave te Bardha jane parashikuar te kalojne ne te dy anet e rruges nen kunetat e betonit.
- ⇒ Tubacionet qe do te perdoren per kete rrjete do te jene Tipi HD-PE-SN -4.
- ⇒ Diametri tyre per cdo rruge eshte dhene ne projekt.
- ⇒ Ujrat e Bardha te te gjitha zones jane parashikuara te shkarkojne ne piken e percaktuar sipas projektit.
- ⇒ Ne kanalizimin e ujrave te bardha jane parashikuar puseta shi-mbledhese cdo 25m

Kanalizimet e ujrave te bardha mbledhin te gjitha ujerat e shirave si dhe ato qe do te shkarkohen nga vaditjet, ambientet e brendshme te qendres, etj. Tubacionet e perdorura per kete sistem do te jene te njejta me ato qe do te perdoren edhe per ujerat e zeza.

Llogaritjet e tubacioneve do te behen ne funksion te intensitetit te shirave per zonen qe studiojme dhe qe do te merret nga banka e te dhenave te Institutit Meteorologjik si dhe te shkarkimeve te tjera shumare qe do te percaktohen nga projekti perfundimtar i zones.

Tubacionet do te shtrihen afersisht ne mes te rrugeve dhe thellesia e tyre e vendosur nuk do te jete me vogel se 1.5m.

Pusetat do te jene prej betoni te papershkueshem dhe ne vendet ku intersektohen me ato te ujrave te zeza do te jene te pajisur me sifone. Kapaket e tyre do te jene prej gize dhe griliato per te mundesuar penetrimin e ujrave, por njekohesisht edhe per te penguar futjen e papastertive ne tubacione.

3.4.1.2. Rrjeti i Kanalizimeve te Ujrave te Zeza

Ne hartimin e rrjeteve te ujrave te zeza eshte marre parasysh;

- Largimi i ujrave te zeza ne menyre te vazhdueshme dhe me renie te lire.
- Ndertimi i rrjeteve te jete sa me ekonomik dhe i lehte per zbatim dhe ne shfrytezim
- Te jete vazhdimisht i mundshem per kontroll dhe pastrim nga lendet e ndryshme qe depozitohen ne te.
- Zgjedhja e trasimit te rrjetit te kanalizimeve ne pershtatje me rrjetin rrugor te zones se banimit dhe kalimit te tyre ne zona te lira dhe te kontrollueshme gjate shfrytezimit.
- Ne ndertimin e rrjetit te Kanalizimeve te Ujrave te Zeza eshte marre parasysh normativa e shkarkimit.

3.4.2. Rrjeti telefonik ne zone ne studim.

Ne lidhje me rrjetin e telefonise publike eshte parashikuar te ndertohet i ri ne te gjithe bllokun e zones. Ne projekt eshte i vendosur ne te dy anet e rruges me dy tubacione 2x200 mm PVC. Gjithashtu jane parashikuar puseta telefonike cdo 40-45m

3.4.3. Gjelberimi i zones ne studim.

Gjelberimi i zones eshte projektuar vetem ne te gjithe gjatesine e rruges ne te dy anet Ne projekt eshte percaktuar distanca dhe lloji pemeve qe do te aplikohet. Ne te dy anet e trotuareve jane parashikuar breza te gjelberuara me bar dekorative. Rendesi ka brezi i gjelber ne anet e rruges i cili do te ndikoj edhe ne uljen e efektit te ndikimit; te zhurmave nga rruga kryesore, nga pluhuri. Pra ky brez i gjelber do te luaj rolin e nje ekrani mbrojtës per mjediset perreth.

3.4.4. Rrjeti i furnizimit me ujë

Rrjeti i furnizimit me ujë ne kete zone nuk ekziston, prandaj ne projekt eshte projektuar ndertimi nje rrjeti te ri te furnizimit me uje te pijshem, duke marre parasysh dhe prespektiven e zhvillimit te kesaj zone periferike.

Furnizimi me uje te pishem do te behet nga pus shpimet i cili momentalisht furnizon veten zona te pjeshme, kjo ka ardhur dhe nga lidhjet e paligjshme ne rrjeti ne furnizimit me uje te pijshem.

Zona ne fjale do te popullohet sipas planit urbanistik te hartuar paraprakisht duke mundesuar llogaritjet paraprake per nevojat e kesaj zone per uje per konsum si dhe sasite e ujrave te zeza dhe te bardha qe do to shkarkohen nga kjo zone. Gjithashtu ne rrjetin inxhinierik te kesaj zone jane parapare edhe rritje te mundshme te cilat duhet te perballohen ne perspektiv nga ky rrjet inxhinierik.

Zone e mesiperme do te furnizohet me uje nga tubacioni kryesor i rrjetit sikurse eshte paraqitur ne planin e rrjetit inxhinierik te zones. Ky rrjet eshte parashikuar te perballoj edhe nevojat per MKZ(pe mbrojtjen kundrejt zjarrit) ne perputhje me normat ekzistuese ne fuqi, nevojat per furnizim me uje te sherbime publike dhe per siperfaqet e gjelberuara.

Sikurse tregohet ne projekt tubacionet do te jene vendosur nentoke ne rruget qe intersekojne ndarjet. Dimensionimi i tyre do te behet ne perputhje me prurjet respektive si dhe me reniet e presionit per cdo linje.

Thellesia e tubacionit kryesor do te jete jo me i vogel se 1.2m ndersa tubacionet e degezimeve jo me pak se 0.8m.

4.1.1. Rrjeti hidrografik te zones ne vleresim

Zona e vleresimit ne aspektin e filtrueshmerise karakterizohet nga tre grupime shkembinjesh dhe dherash qe jane:

- Zhavoret prluviale
- Suargjilat deluviale
- Shkembinjte argjilo-alevrolitiko-ranore te Neogjenit(N_1^3t).

Nga vrojtimet e kryera ne punimet e shpimit u konstatua se niveli i ujerave nentokesor eshte poshte 10.0m pervec ne tarracen e pare te lumit qe rezulton te jete 4.0-4.5m nga siperfaqja e tokes. Kjo tarrace qe i perket zones se pare gjeologjike ndertohet nga nje shtrese zhavoro-ranore me trashesi deri ne 4.0m e cila permban ujera nentokesor qe kane lidhje hidraulike. Brenda kesaj shtrese qarkullojne ujera te shumte nentokesor, per vete faktin se ajo paraqitet pa lidhje kohezionale. Kjo shtrese mbulohet nga suargjila deluviale me filtrueshmeri te ulet.

Shtresa e suargjiles qe mbulojne shembinjte rrenjesore kane nje filtrueshmeri shume te ulet dhe praktikisht ato pengojen ujerat e shiut(rreshjet) si dhe siperfaqesor qe te depertojne ne shkembinjte rrenjesor. Shtresa e suargjiles ka nje filtrueshmeri shume te vogel dhe praktikisht nuk lejojne ujerat nentokesor te qarkullojne ne drejtim te shkembinjve rrenjesore.

Parametrat hidraulik te dherave ndryshojne nga nje sektor ne tjetrin per shkak te ndryshimeve te medha ne trashesine dhe menyren e formimit te tyre, por edhe te ndryshimeve te perberjes granulometrike dhe litologjike si ne drejtimgjeresor dhe ne ate gjatesor. Ne prodhimet deluviale dhe aluviale pervec ujerave nentokesor te trajtuar me larte ne rajonin e studiuar takohen ujerat e varura me karkter sezonal qe

formohen ne ndershtresat e rerae brenda suargjilave. Ndersa grupi i shkembinjve te neogjenit ka nje filtrueshmeri mjaft te ulet. Kjo vjen per vete faktin e ndertimit te tyre nga shtresa argjilo-alevrolitore.

Mineralizimi i pergjithsme i tyre luhatet nga 322mg/l deri ne 500-600mg/l. Ne lidhje me perberjen kimike, uji eshte i tipit $\text{HCO}_3 - \text{Ca-Mg}$. Nga te dhenat hidrokimike te ujrave te zones del se nuk jane agresive ndaj hekurit-betonit.

4.1.2. Zonat e ndjeshme mjedisore

Zona ne vleresim nuk klasifikohet ne listen e zonave me status te vencante, eshtre nje zone e zakonshme dhe ndodhet ne qender te qytetit te Memaliajt. Nuk eshte zone nderkufitare prandaj nuk ka ndikim nderkufitar ne mjedis.

4.2. Cilesia e ajrit

Aktivitetet gjeneruese te ndotjes se ajrit jane shtuar si rezultat i zhvillimeve te disa sektorëve ekonomikë, sidomos te transportit, ndertimit, furnizimit te pamjaftueshem dhe aritmik me energji, etj.

Transporti

Burimet e levizshme gjenerojne nje kompleks ndotesish, e bejne ndotjen difuze dhe riciklojne pluhurat e depozituar. Sipas te dheneve te literatures llogaritet qe automjetet te jene pergjegjese per leshimin ne mjedis te 24 % te pluhurit (lendes se grimcuar pezull), 77 % te CO (monoksidit te karbonit), 49 % te NOx (gazeve nitroze), afër 90% te Pb (plumbit), etj.

Ndertimi

Spektori i ndertimit eshte nje burim i fuqishem ndotje ne pikepamje te mases se pluhurizimit e cila rrit ndotjen ne hapesirat ku behen ndertimet dhe sasinë e pluhurit te depozituar. Edhe pse pergjithesisht kemi te bejme me pluhur te kategorizuar si 'inert', nje lloj i tille pluhuri ndikon ne masen e pluhurizimit te regjistruar nga monitorimi, rrit nivelin e ndotjes se brendshme (banesave etj.), krijon ndjenje te forte papastertie tek qytetarët dhe eshte bartes i mikrobeve.

Energjia

Per sa i perket Energjise eshte e veshtire te vleresohen kontributet pozitive e negative te saj ne ndotjen e ajrit. Fakti qe popullata perdor 'me bollék' energji nga burimet hidrike vazhdon te luaje nje rol pozitiv te jashtezakonshem. Çdo reduktim i kesaj lloj energjie ne favor te asaj nga lendet fosile do te perkeqesonte me tej situaten ekzistuese.

4.2.1. Profilet e ndotjes se ajrit

Periudha deri 1990/1991

Memaliaj

- lëvizje demografike të kontrolluara;
- aktivitete industriale me potencial të madh ndotës, të vendosura në periferi të qytetit;
- transport rrugor me numër të kufizuar makinash;
- përdorim i kombinuar i energjisë elektrike (kryesisht për ndriçim) me atë nga lëndët fosile (për gatim, ngrohje të banesave);
- ndërtime me një rritëm jo edhe aq intensiv; etj.

Periudha 1992/2003

- lëvizje demografike e vrullshme, e pakontrolluar me rritje shumë të shpejtë të numrit të banorëve;
- kolaps thuajse i plotë i industrisë me potencial të madh ndotës;
- rritje galopante e transportit rrugor;
- konsum i energjisë elektrike për ndriçim, gatim, etj.
- boom i ndërtimeve;

Faktorët e mësipërm japin shkas për gjenerimin e agentëve prishës të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të cilësisë së ajrit urban (veçanërisht në nivelin e banorëve) në kuptimin më të gjerë të fjalës si:

- Agjentë fizik: zhurma dhe /ose vibracione, Radoni, FEM
- Agjentë Kimik: pluhuri (total, PM10, PM2.5) dhe bloza; NOx, SO2, POPs, VOCs, etj.
- Agjente mikrobikë; etj.

4.2.2. Te dhena ekonomiko-sociale

Zona e marre ne studim ndodhet ne Qytetin e Memaliajt, kjo zone ka nje popullsi vendase. Numer shume i madh biznesesh operojne ne zone duke krijuar nje premise per te gjeneruar te ardhura per Komunen. Disponojme keto te dhena per kete komune:

- 220 biznese i vogel
- 80 biznese te medha
- 200 te punesuar ne sektorin shteteror
- 180 te punesuar ne sektorin privat
- Me pak se 10% e popullsise perfitojne nga skemat e ndihmes ekonomike

5.1 Metodologjia e vleresimit

Metoda e vleresimit te ndikimit te clirimeve ne ajer te impianteve mbeshtetet ne VKM Nr.435 date 12.09.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimet ne ajer te RSH" ku ne piken pika 5.1.2 por ne menyre direkte nuk eshte pjese e kesaj pike pasi nuk kemi proces diegie ne kete spital, ne kete pike percaktohen vlerat limit te shkarkimeve ne ajer per procese te trajtimit te mbejteve spitalore me diegie(icenerator).

Skema e projektimi dhe e modelimit do te perqendrohet ne vleresimin real te zones dhe distanca e ambjenete te banimit nga kjo qender si me poshte shpjeguar:

- Vleresimi i pikave me kritike qe duhen monitoruar
- Piketimi i zonave ku do te montohen pajisjet e monitorimit per ajerin si dhe per zhurmat si ne brendesi te objektit dhe ne mjedisin rrethues
- Percaktimi i pikave stabel per te realizuar nje monitorim 24 h dhe vjetor, ne varesi te vlerave qe do te monitorohen.
- Ndertimi i nje harte ku te hidhen te dhenat e monitorimit si dhe ruajtja e ketyre te dhenave ne database si dhe paraqitja e kesaj permbledhje tek inpektoriati i mjedisit dhe i shendetit.
- Percaktimi i kushteve klimaterike te zones si dhe ne vecanti i trendafilit te eres.
- Per nje vleresim sa me real eshte e rendesishme te merren parasysh dhe kushtet e terrenit si dhe e terrenit perreth.

Eshte e rendesishme te theksojme se eshte e rendesishme te dihen sakte te dhenat teknike te pajises te cilat jane pjese e katalogut ne blerje, vleresimi i ketyre paramentrave me ato real bene te mundur te vleresimin e gjendjes ne te cilen ajo punon dhe ngarkesen.

Monitorimi i vazhdueshem i ketyre treguesve do te conte ne uljen e impaktit te vleresimit. Eshte e rendesishme qe pajisjet e monitorimit te montohen ne pozionet e pershtatshem si dhe jo prane pengesave ku te shmagen prania e objeteve te tjera prane, te vendosen ne nje lartesi me te larte se tubi i shkarkimit si per mjediset e punes dhe per mjediset e jashtme. Respekti i kushteve te montimit te pajisjeve monitoruese eshte shume e rendesishme pasi do te kishte impakt ne perfundimet. Ne kete projekt nuk identifikohen zona te ndjeshme apo me status te vecante si dhe zona ndodhet larg rruges kryesore dhe komunitet vendas.

5.2 Normat e clirimeve ne ajer / uje dhe respektimi i nivelit te zhurmave konform legjislacionit te fuqi.

Mbeshtetur ne kuadrin ligjor shqiptar ky projekt duhet te zbatohet normat e shkarkimit te ajer/ uje dhe niveli i zhurmave konform kesaj baze ligjore:

- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"

- VKM Nr.435, date 12.09.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimit ne ajer ne Republiken e Shqiperise."
- Udhëzim Nr.8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara"

1. Normat e shkarkimit per linjen e djegies se mbetjeve te rrezikshme dhe spitalore(jo pjese e ketij projekti)

Parametrat	Vlerat limit shqiptare mg/m ³	Vlerat limit europiane mg/m ³
PM	-	200
LN	30	
CO	100	100
SO ₂	300	300
VOC	-	20
NO ₂	500	-
Te tjera		20 ¹ 30 ² 2 ³ 0.05 ⁴ 2.0 ⁵ 5.0 ⁶

Ky projekt nuk bene pjese ne kete kategori.

¹ Komponime organike te shprehur si karbon i pergjithshem

² Komponime te gazta te klorit te shprehura si klorur hidrogjeni

³ Komponime te gazta te floritte shprehura si florur hidrogjeni

⁴ Merkur, talium dhe kadmium i pergjithshem ne gaz, leng dhe faza te ngurta

⁵ Shuma e arsenikut, nikeli, kromit dhe kobaltit ne gaz, leng dhe faza te ngurta

⁶ Shuam e plumbi, bakrit dhe manganit ne gaz, leng dhe ne faze te ngurte

2. Normat e shkarkimeve te ujerave te ndotur urbane ne rrjetin perkates te zones apo ne mjedise ujore pritese.

Ne asnje rast ky aktivitet nuk permendet ne kete baze ligjore si dhe normat e shkarkimeve ne uje per kete veprimtari si dhe mbeshtur ne Direktiven e Keshilit Europian date 21 maj 1991 " Ne lidhje me perpunimin e ujerave te ndotur (91/271/EEC) Shtojca 3 nuk eshte pjese e kesaj liste, prandaj kufizohemi ne faktin se zona ne vleresim do te nenshtrohet respektimit te normave te shkarkimit te ujerave urbane sipas metodave perkatese referente te cilet do te shkarkohen ne mjedise pritese jo te ndjeshme si me poshte

Parametrat	Perqendrimi Vlera limite shqiptar	Perqendrimi Vlera limite europiane
Nevoja biokimike per oksigjen NBO-5 ne 20° pa nitrifikim	25mg/l O ₂	25mg/l O ₂
Nevoja kimike per oksigjen-NKO	125 mg/l O ₂	125 mg/l O ₂
Lendet totale ne suspension	35 mg/l per me shume se 10 000nj.p(per nenin 4-2)	35 mg/l per me shume se 10 000nj.p
Lendet totale ne suspension	60 mg/l per me shume se 2 000-10 000nj.p (per nenin 4-2)	60 mg/l per me shuem se 2 000- 10 000nj.p

3. Niveli kritik i zhurmave per kete projekt.

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	LAm _{ax} Fast (dB)
Zona me aktivitetet social- ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110

Projekti ne vleresim do te instalohet ne zone te azhornuar si zone industriale sipas Studimit te pergjithshem urbanistik per zonen perendimore prandaj duhe respektuar keto vlera kritke te zhurmave si per mjediset e pune dhe jashte saj.

4. Plani i menaxhimit dhe monitorimit

Plani i menaxhimit dhe i monitorimit do te kerkoj te monitorohet efektiviteti i masave zbutese qe do te merren dhe do te raportohen ne agjensine perkatese dhe ne inspektoriatin e mjedisit. Monitorimi i treguesve te mjedisit eshte e rendesishem pasi ne kete forme vleresohet ky aktivitet, ne kete menyre do te parandalohen impaktet negative te projektit ne mjedis.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasimore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjedisive ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te Vendimit Nr.103. date 31.03.2002 "Per monitorimit e mjedisit ne RSH", kreu III, pika 10 dhe mbeshtur ne Udhezimin e "Vetmonitorimit":

Investitori do te monitoroje keto tregues te trysnise ne mjedis te cilet jane:

Ç-1. Per ndryshimet klimaterike(a, b);- nuk do te monitorohen nga investitori sepse nuk ka ndikim kjo veprimtari(zone industriale) ne keto tregues mjedisor ne permasa kaq te larta sa te ndikoj ne ndryshim te klimes se ketij rajoni pasi ne kete objekt nuk do te ushtrohet asnje proces industrial me shkarkim ne ajer, shpjeguar tek impakti dhe nuk do te emetohen ndotesa industrial te gazte ne kete zone.

Ç-2. Per ajrin urbane(a, b, c, ç, d);- gjate fazes se ndertimit ne bashkepunim me inspektoriatin e mjedisit do te monitorohet cilesia e ajrit urban, ku do te monitorohen keto tregues gjate fazes se ndertimit si:

- Oksidet e Azotit (NO_x),
- Lenda e grimtuar ne suspension, kryesisht pluhuri total LGS dhe ai i respirueshem PM10,-- keto emisione mund te clirohen gjate fazes se germimit dhe rehabilitimit te zones perreth dhe do te monitorohen gjate punimeve, ne raste kur ka erera te forta do te nderpriten punimet e germimeve.
- Dyoksidi i sqfurit (SO₂),-- qe mund te clirohet ne permasa shume te ulta nga lendet djegese te ndonje mjeti rrugor ndertimor.
- Ozoni (O₃),
- Plumbi,-- nga djegia e benzines tek mjetet rrugore ndertimore.

Ne lidhje me gjeneratorin ndotja do te jete ne nivele te uleta pasi duhet te perdorin D2 si lende djegese, i cili eshte i kontrolluar me perpara nga institucionet perkatese para se te mbihet nga kjo veprimtari. Gjeneratoret duhet te jene te standartizuar konform kushteve te vendeve te KE-se.

Openimi i pajisjeve dhe i makinerive gjate gjithë procesit te ndertimit te dhe funksionimit, kerkon te monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet te kaloje nivelet e caktuara. Ndotja akustike ne mjediset e punes(ne kantier) eshte paresore per shoqerine, sepse sjell uljen e produktivitet te punonjesve dhe rritje te stresit(efekte eksta-auditive).

Ç-5. Per shkarkimet e ngurta , industriale dhe inerte(a, b, c, ç, d);-- plani i monitorimit gjata ndertimit, lidhur me pastrimin dhe pergatitjen e sheshit, ka si synim qe te evitohet prerja e drureve gjate pergatitjes se shesheve te ndertimit. Hedhja e materialeve te nxjerra nga pergatitja e objekti per te instaluar kete impiant kerkon mbajtjen e shenimeve perkatese ne regjistrimin e punimeve te kryera. Per kete qellim duhet te behet dokumentimi i materialeve te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e paracaktuara nese ka te tilla.

Gjithashtu dergimi i materialeve te ndertimit dhe i pajisjeve ne shesh ben te nevojshem inspektimin e perhershëm, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dheut.

Ne raste se konstatohet qe masat nuk jane zbatuar ashtu sic duhet ateherë eksperti do te njoftoje menjehere kontraktuesin dhe supervizorin i cili do te jete i pergjegjshem qe te merren masat e duhura dhe korrekte.

Gjate fazes se operimit kur te filloj procesi i trajtimit te mbetjeve do te inspektohen te gjithë proceset e punes gjate dites dhe mbetjet qe do te dergohen per tu depozituar ne venddepozitimin perkates si mbetje te zakonshme te ngurta urbane nga ekspertet perkates per tu siguruar qe masat e trajtimit dhe paketimit jane siguruar sic duhet. Nuk do te devijohet nga qellimi dhe destinacioni i kesaj shtepie kurimi.

Ç-6. Per shkarkimet e lengeta industriale(a, b, c);-- do te kete monitorim te ndotesave te lenget per te shmangur ndotje te ujerave te ndotur urban.

Monitorim do tu behet shkarkimeve te lengeta qe do te prodhohen gjate zbatimit te ketij projekti. Ne fillim monitorohet para ndertimeve per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilesise se ujit rekomandohet ne zonat me burimet me te medha te ndotjes potenciale te ujit (kampet e ndertimit dhe te burimeve te tjera te rrjedhjeve te rendesishme dhe prodhimit te ndotesve te lenget jo industrial.

Rekomandohet matja e grimcave ne suspence (MES), kerkesa biologjike per oksigjen DBO_5 , konduktiviteti dhe coliformet fekale dhe niveli i vajrave e grasove.

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet nga inspektoret e mjedisit(supervizori) gjate punimeve. Monitorimi i ujerave te ndotura urbane gjate shfrytezimit nuk do te realizohet nga banoret e zones pasi eshte detyre e institucioneve perkatese shteterore.

Ç-7. Per burimin e ndotjes qe shkaktojne ne ajer;-- burimet kryesore qe shkaktojne ndotjen e ajerit gjate ndertimit jane; nga automjetet rrugore qe do te perdoren, nga rikonstruksioni i brendshem, nga pajisjet e ndryshme, nga njerezit, etj.

Ndersa gjate funksionimit do te prodhojne ndotje te ajerit ne nivele te uleta si: automjetet rrugore, gjeneratori, etj.

Monitorimi para ndertimeve per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe ka vendosur supervizori, perbrenda zones qe do te ushtrohet ndikimi.

Monitorimi me aparate per ndotesit e ajerit,pervec grimcave totale ne suspence nuk konsiderohet e justifikueshme ne kushtet ekzistuese te ambientit, sepse nuk ka impakte te rendesishme ne kete projekt.

Masat e sigurise per monitorim shtese me kerkese te supervizorit do te specifikohen nese hasen rrethane te paparashikuara.

Ç-8. Sasia vjetore e kimikateve te rrezikshme te importuara.—ky studim nuk perfshin ne asnje stade importimin e kimikate te rrezikshme te asnje lloj, te demshme per mjedisin natyror dhe njerezor. Mbetjet qe do te trajtohen klasifikohen si mbetje te rrezikshme por jo klasifikimi i kimikateve.

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndotjet e mundshme qe do t'i shkaktohen mjedisit nga zbatimi dhe shfryezimi i ketij projekti do te jene ne nivele te pranueshme dhe ne perputhje me nivelet e percaktuara ne legjislacionin/direktivat perkatese. Investitori do te monitoroje vetem pikat per te cilat ai ndikon mbi to(pikat do te percaktohen nga organet kompetente), si dhe i dergojne keto te dhena ne Agjensine Rajonale te Mjedisit(ARM-ja e qarkut Gjirokaster), te paktën kater here ne vite. Keto te dhena do te vihen ne dispozicion te

inspektoreve te mjedisit gjate inspektimit te tyre ku nga ana e firmave kontraktuese do te kete gjithmon bashkepunim.

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar.

Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar gjate aktivitetit, do te çoje perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me siperfaqe te sistemuar dhe te gjelberuar.

5. Rekomandime

- Respektimi i Plan Menaxhimit Mjedor per fazen e ndertimit qe do te percaktohet ne menyre specifike nga shoqeria perkatese
- Rehabilitimi i zones pas zbatimit konkret te projektit dhe shmangia e degradimit te mjedisit natyror te zones perreth kesaj zone.
- Te respektohet habitatin e zones perreth pa ndikuar ne ciklin e tyre te jeteses ne harmoni me natyren.
- Perdorimi me eficence te energjise elektrike dhe ujit si dhe hartimi i nje plani per perdorim te pajisjeve me eficence energjitike si dhe e burimeve te rinovueshme per prodhimin e avujve te ujit.
- Monitorim te vazhdueshem te treguesve mjedor per te shmatur mbi kalim te normave te shkarkimit per kete veprimtari (eshte pjese e listes se normave te shkarkimeve ne uje-ujerat urbane) prandaj duhet te konsultohen me institucionet pergjegjese.
- Kontenjeret e seleksionimit duhe te jene specifik sipas llojit te mbetjeve dhe ne perputhje me katalogun perkates per paketim te ketyre mbetjeve te ngurta.
- Mirembajta dhe gjelberimi ne menyre te vazhdueshem te mjedisve perreth aktivitet duke shmatur nje imazh te nje zone te braktisur dhe ne kundarshtim me vete qellimin e saj.
- Respekti i i kodit te punes dhe planit te emergjences si dhe i rregulloreve te brendshme te vete veprimtarise.

Raporti i Vleresim Ndikimit ne Mjedis u pergatit nga:

Ing.Mjedisi.Fatjona Levani